

## PROCESVERBALI

Nga mbledhja urgjente e Kuvendit të Komunës së Graçanicës,

E mbajtur më datën 07.04.2025 në sallën e Kuvendit të Komunës së Graçanicës dhe filloi në orën 13:00.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Graçanicës, Millan Dimitrijeviq, hapi mbledhjen duke i përshëndetur të gjithë të pranishmit dhe shtoi se në mbledhje nga 19 asamblistë janë të pranishëm 16 asamblistë dhe ka kuorum, ndërsa mungojnë: Sonja Odallovic, Jellena Dimitrijeviq dhe Snezhana Jovanovic.

Në mbledhje morën pjesë edhe përfaqësuesit të KFOR-it, përfaqësuesit e OSBE-së, kryetarja e Komunës së Graçanicës, drejtori i Drejtorisë Komunale të Kadastrës, avokati publik i komunës, mediat, pastaj Shërbimi për Përkthim, Shërbimi për Informim dhe Shërbimi për Çështjet e Kuvendit.

Kryesuesi e vuri në votim rendin e propozuar të ditës.

**Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 16 asamblistëve “Pro”, miratoi rendin e mëposhtëm të ditës:**

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e tretë e rregullt, e mbajtur më datën 24.03.2025.
2. Shqyrtimi i situatës së re në lidhje me fillimin e ndërtimit Qendrës rehabilituese dhe edukative në vendbanimin Padallishtë në Graçanicë, me propozim të kryesuesit të Kuvendit Komunal të Graçanicës, Millan Dimitrijeviq.
3. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e tretë e rregullt, e mbajtur më datën 24.03.2025.

**Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 16 asamblistëve “Pro”, miratoi pikën e parë të rendit të ditës.**

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Shqyrtimi i situatës së re në lidhje me fillimin e ndërtimit Qendrës rehabilituese dhe edukative në vendbanimin Padallishtë në Graçanicë, me propozim të kryesuesit të Kuvendit Komunal të Graçanicës, Millan Dimitrijeviq.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Graçanicës, Millan Dimitrijeviq, theksoi se përkundër kundërshtimit të Komunës së Graçanicës lidhur me lokacionin e Qendrës rehabilituese dhe edukative, ndërtimi ka filluar.

“Përkundër faktit se kjo është një zonë që nuk është deminuar plotësisht dhe gjendet pranë një sasive të madhe pluhuri, përkatësisht djerrinës dhe ajo që është më e rëndësishme për vetë komunën, është e vetmja zonë ku mund të ndërtohen institucionet e vetë Komunës, nuk janë dëgjuar lutjet dhe kërkesat tona, as nuk janë marrë përgjigjet pozitive ndaj të gjitha kërkesave të Kuvendit të komunës, para së gjithash edhe të administratës së Komunës së Graçanicës nga Qeveria e Kosovës. Ata në mënyrë të njëanshme, pa asnjë pyetje, me vendimet e tyre të njëanshme kanë shkelur gjithçka që ka të bëjë me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale, i cili është ligji ombrellë për çdo komunë. Ajo që është e rëndësishme të theksohet është se, sipas informacioneve që kemi, Komuna e Prishtinës ka ofruar nja dy lokacione më të mira për ndërtimin e kësaj qendre, por Qeveria e Kosovës këtë gjë e ka refuzuar”.

Drejtori i Kadastës, Dushan Fillipoviq, shpjegoi se si dhe kur ka ndodhur ndryshimi në kadastër. “Siç e dini, me vendimin përfundimtar të Qeverisë së Kosovës është paraparë që Komunës së Graçanicës t’i merret një pjesë e tokës. Drejtoria e Kadastrës ka konstatuar se me 5 mars të këtij viti është kryer parcelizimi dhe bartja e pronësisë. Kur i kemi vërejtur ndryshimet e kemi njoftuar kryetaren e komunës dhe avokatin publik të komunës dhe menjëherë pas kësaj janë ndërmarrë veprime të caktuara ligjore për ta parandaluar këtë”.

Avokati publik i komunës, Negovan Sharanoviq, i njoftoi asamblistët me masat e ndërmarra dhe mjetete juridike për shfuqizimin e Vendimit të kontestuar të Qeverisë së Kosovës për konfiskimin e tokës nga Komuna e Graçanicës. Gjatë marrjes së vendimit të kontestuar, Qeveria e Kosovës është udhëzuar nga Ligji për Pronën Publike, përkatësisht neni 16 - Kalimi i pronës së paluajtshme në pronësi publike, me qëllim të realizimit të interesit publik. Ai theksoi se në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës është dorëzuar iniciativa për vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, si dhe propozimi për përcaktimin e masës së përkohshme që do ta pezullonte zbatimin e Vendimit të Qeverisë së Kosovës.

“Pas pranimi të vendimit, Komuna e Graçanicës, me iniciativë të kryetares së komunës, ka formuar një ekip ekspertësh me qëllim të parandalimit të pasojave të dëmshme për Komunën e Graçanicës dhe pezullimin e zbatimit të tij. Në këtë aspekt, në Gjykatën Themelore në Prishtinë është parashtruar padia për anulimin e aktit administrative, me propozim për pezullimin e ekzekutimit të vendimit të Qeverisë së Kosovës, për të cilin Gjykata ende nuk ka caktuar shqyrtim kryesor, por kërkesa është refuzuar. Prandaj, kundër vendimit të shkallës së parë është bërë ankesë në Gjykatën e Apelit dhe ende nuk është marrë vendimi ndaj ankesës. Në ndërkohë, për t’i shteruar të gjitha mjetet juridike të mundshme dhe për të vepruar në mënyrë institucionale, Komuna e Graçanicës e ka dorëzuar iniciativën në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës për vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së Vendimit të Qeverisë së Kosovës, së bashku me propozimin për përcaktimin e masës së përkohshme që do ta pezullonte zbatimin e Vendimit

të Qeverisë së Kosovës deri në marrjen e aktvendimit. Procedura para Gjykatës Kushtetuese është në proces dhe presim një vendim së shpejti”.

“Në padinë administrative pranë Gjykatës Themelore të Prishtinës dhe iniciativën për vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë pranë Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, prioritet i është dhënë kundërshtimeve ndaj veprimit të njëanshëm të Qeverisë së Kosovës gjatë miratimit të Vendimit për konfiskimin e pronës së paluajtshme që ishte në pronësi të regjistruar të Komunës së Graçanicës. Një veprim i këtillë i Qeverisë së Kosovës është jotransparent dhe jo gjithëpërfshirës, i karakterizuar ekskluzivisht si i njëanshëm, duke pasur parasysh se Komuna e Graçanicës nuk ishte e informuar nga Qeveria e Kosovës dhe as ministria kompetente, e as nuk ishte konsultuar gjatë përgatitjes së projektit për ndërtimin e Qendrës rezidenciale...”

“Me përjashtimin e Komunës së Graçanicës nga procesi që i ka paraprirë miratimit të Vendimit të Qeverisë së Kosovës, Komuna e Graçanicës është sjellë para një fakti të kryer, me të cilin ekzekutimi i pronës së saj është kryer pa marrë parasysh interesat e vetë Komunës dhe planet e saja për njësitë kadastrale të konfiskuara”.

Sharanoviq rikujtoi se Komuna e Graçanicës tashmë ka ndërtuar objekte administrative dhe sociale në vendbanimin Padallishtë dhe se ishte planifikuar zbatimi i shumë projekteve të tjera, si ndërtimi i parkut diellor, ndërtesa administrative e Kompanisë Rajonale të Ujësjiellit, ndërtesa administrative e Ndërmarrjes Publike “Ekologjia” dhe se këto plane tani janë ndërprerë me Vendimin e Qeverisë së Kosovës. Ai shtoi se është evidente se me këtë vendim të njëanshëm Qeveria nuk ka marrë parasysh se po e dëmton zhvillimin e përgjithshëm dhe ekonomik të komunës dhe qytetarëve të saj. Nga sa më sipër, konstatohet qartë se Vendimi është i kundërligjshëm dhe në kundërshtim me parimet themelore të procedurës.

“Qëndrimi ynë është që Vendimi i Qeverisë paraqet akt administrativ në formë të dekretit, i cili është në kundërshtim me parimet e demokracisë, sepse me imponimin e vendimit cenohen interesat e Komunës së Graçanicës dhe më gjerësisht dëmtohet kontributi i saj në zhvillimin e përgjithshëm si të Komunës së Graçanicës, ashtu edhe të Kosovës”, tha Sharanoviq.

Asamblisti Millosh Todoroviq, para partisë “SRPSKA” pyeti nëse ka bazë ligjore për ndalimin e punimeve derisa shqyrtohet ankesa e komunës.

Avokati publik i komunës, Negovan Sharanoviq, u përgjigj: “Padia është parashtruar në Gjykatën Themelore, e cila është mjet i rregullt juridik, por është parashtruar edhe ankesa kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës dhe kjo është mundësia më e lartë që ne të realizojmë disa nga të drejtat tona”.

Asamblisti Nebojsa Markoviq, para partisë “SRPSKA” pyeti nëse fillon ndërtimi i qendrës, a e lëshon lejen ndërtimore Komuna e Graçanicës apo këtë leje e jep qeveria qendrore.

Kryesuesi u përgjigj se ata pa asnjë kërkesë kanë urdhëruar që të lëshohet leja për kyçje të ujit dhe energjisë elektrike, pa bazë ligjore.

Kryetaria e Komunës së Graçanicës, Ljiljana Shubariq, theksoi se nëse Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës e urdhëron këtë qeverisje lokale që t'i japë leje Qeverisë së Kosovës për shfrytëzimin e parcelës të caktuar, sipas saj, Komuna do të duhet të veprojë sipas urdhrit.

Asamblisti Dushan Borisavljeviq, para partisë "SRPSKA" tha se gjatë vendosjes së gurthemelit janë hequr të gjitha billbordet dhe se qytetarët e Komunës së Graçanicës nuk kanë qenë fare në dijeni se çfarë është duke u ndërtuar atje, e aq më pak për vendimin e marrë.

Kryesuesi hodhi në votim kërkesën që do t'ia dërgojnë Qeverisë së Kosovës, me të cilën do të kërkojnë anulimin e Vendimit nr.05/218 të datës 28.08.2024 për marrjen e tokës nga Komuna e Graçanicës si dhe që të gjithë hapat e mëtejshëm t'i ndërmarrë në marrëveshje me Komunën e Graçanicës dhe Kuvendin e Komunës së Graçanicës, si organ ligjvënës të saj, si dhe ta respektojë nenin 14 dhe nenin 17 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale.

"E gjithë kjo që po bën Qeveria e Kosovës është e njëanshme, e gjithë kjo po ngre edhe më shumë tensione, e gjithë kjo po e shqetëson popullatën dhe nuk çon në asnjë bashkëjetesë paqësore nga njëra anë, dhe nga ana tjetër, e hedh poshtë çdo marrëveshje, sepse është bërë sipas parimit që mund të bëj si të dua. Qeveria e Kosovës e ka treguar shumë herë këtë dhe ne e kemi ndjerë vetë dhe shpresojmë që më në fund faktori ndërkombëtar do t'i mbledhë forcat dhe do të thotë mjaft me shkeljen e ligjit, mjaft me shikimin e sjelljeve të dhunshme të pushtetit qendror, mjaft me shembjen e institucioneve. Sepse kemi ardhur deri te fakti se përfaqësuesit e komunitetit ndërkombëtar janë thjesht vëzhgues të heshtur që shikojnë në heshtje se si çdo gjë që ata kanë potencuar dhe ndërtuan vazhdon të shembet, sepse ata e konsideronin veten përgjegjës për ruajtjen e rendit dhe punës", tha kryesuesi.

**Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me votat e 15 asamblistëve "Pro", dhe 1 "Kundër" të Granit Gashit, miratoi kërkesën e paraqitur nga kryesuesi.**



Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e tretë të rendit të ditës:

3. Të ndryshme.

Pasi që askush nuk e mori fjalën për të diskutuar lidhur me pikën "Të ndryshme" të rendit të ditës, kryesuesi falënderoi për bashkëpunim dhe mbledhja mbaroi në orën 13:34.

Procesmbajtësi:

Agron Karadollami



Kryesuesi i Kuvendit Komunal

Milan Djmitrijević